



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
DREJTORIA EKONOMIKE, BURIMEVE NJERËZORE
DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

NJOFTIM

Për plotësimin e një vendi të lirë pune në administratën e Gjykatës Kushtetuese.

Në zbatim të nenit 14/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, Gjykata Kushtetuese shpall procedurat e plotësimit të një vendi të lirë pune në pozicionin:

Këshilltar ligjor i Njesisë së Shërbimit Ligjor

Pozicioni më sipër, ofrohet për të gjithë kandidatët nga brenda dhe jashtë institucionit të Gjykatës Kushtetuese që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për të konkurruar.

Qëllimi i përgjithshëm i pozicionit të punës:

Bazuar në nenin 14/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenin 12 të Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës së Gjykatës Kushtetuese, këshilltari/ja ligjor/e ushtron funksionin e tij/saj në përbërje të Njesisë së Shërbimit Ligjor, e cila përbën bërthamën shkencore juridike të Gjykatës Kushtetuese dhe ushtron veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin vendimmarrës të Gjykatës Kushtetuese.

Përshkrimi i detyrave që kryen këshilltari ligjor:

Këshilltari/rja ligjor/e ka si detyra kryesore, në ushtrimin e veprimtarisë së tij/saj, sa vijon:

- përgatitjen e çështjeve për gjykim;
- dhënien e opinioneve ligjore dhe/ose përgatitjen e kërkimeve shkencore për çështjet gjyqësore që janë për shqyrtim para Gjykatës Kushtetuese;
- përgatitjen e relacionit për shqyrtimin paraprak të çështjeve dhe të çdo materiali tjetër të nevojshëm;

- përgatitjen e projektvendimeve të kolegjit, Mbledhjes së Gjyqtarëve dhe të Gjykatës, sipas udhëzimeve të gjyqtarit relator;

Këshilltari kryen edhe detyra të tjera si më poshtë:

- kujdeset që aktet e përgatitura prej tij të jenë në përputhje me praktikën e Gjykatës Kushtetuese dhe asaj të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- mban parasysh dhe zbaton udhëzimet e miratuara për standardet, metodologjinë, referencat dhe çështje të tjera në përgjithësi;
- përditëson të dhënat e çështjeve dhe përgatit çdo material tjetër informues të nevojshëm në këtë drejtim;
- propozon nevoja dhe kërkesat për kualifikime dhe trajnime profesionale;
- propozon tituj të literaturës juridike;
- harton raporte në lidhje me pjesëmarrjet e tij në veprimtaritë e caktuara;
- angazhohet me detyra me karakter shkencor, kërkimor dhe statistikor në kuadër të marrëdhënieve ndërinstitucionale të Gjykatës;

Këshilltari/rja ligjor/e kryen çdo detyrë tjetër që i caktohen Kryetari, Mbledhja e Gjyqtarëve ose gjyqtarët.

Kushtet dhe kriteret e veçanta që duhet të plotësojë kandidati për këshilltar/e ligjor/e:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë shtetas shqiptar ose të zotërojë gjuhën shqipe;
- c) të mos jetë dënuar me vendim penal të formës së prerë;
- ç) të plotësojë kriteret e legjislacionit për dekriminalizimin;
- d) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike gjatë 5 vjetëve të fundit;
- dh) të mos ketë ndaj tij:
 - i. masë disiplinore në fuqi;
 - ii. masë disiplinore për largim nga detyra, pavarësisht nëse masa disiplinore konsiderohet e shuar;
 - iii. masë ndaluese për të punuar në funksione publike.
- e) të kalojë me sukses verifikimin e plotë të pasurisë dhe të figurës sipas legjislacionit në fuqi;
- ë) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, DND, DIND ose “Bachelor” + “Master Shkencor” në shkencat juridike;
- f) të ketë mesatare mbi notën 8 ose ekuivalentin e kësaj note sipas sistemit ku janë kryer studimet;
- g) të ketë qenë gjyqtar ose prokuror me përvojë jo më pak se 5 vjet;
- gj) të ketë përvojë si jurist jo më pak se 10 vjet si:

- i) lektor i së drejtës;
- ii) avokat;
- iii) nëpunës i lartë i administratës publike;
- iv) funksione këshillimi ligjor në organet e sistemit të drejtësisë ose në organizata, programe dhe projekte me fushë veprimi në sistemin e drejtësisë ose në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Kriteret:

- a) kryerja e studimeve pasuniversitare;
- b) veprimtaria në fushën akademike (*mësimdhënie, botime artikujsh, përgatitje trajnimesh ose çdo veprimtari e ngjashme me to*);
- c) përvoja në sistemin e drejtësisë;
- ç) aftësitë draftuese;
- d) zotërimi i gjuhës angleze (*të shkruar dhe të folur*);
- dh) njohja e çdo gjuhe tjetër përbën avantazh.

Fusha e njohurive për kandidatët që do të konkurrojnë:

Kandidati duhet të zotërojë:

Njohuritë për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë; Ligjin për organizimin e funksionimin e Gjykatës Kushtetuese; Rregulloren për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese; Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Kodin Civil; Kodin e Procedurës Civile; Kodin Penal; Kodin e Procedurës Penale; Kodin e Procedurave Administrative; Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale; Ligjin për rregullat e etikës në administratën publike; Ligjin për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare; Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Mënyra e komunikimit

Njoftimet dhe komunikimet për kandidatët do të bëhen në faqen zyrtare të Gjykatës Kushtetuese, si dhe me e-mail, ose celular (*sipas rastit*).

Dokumentacioni, afati i dorëzimit dhe mënyra e dorëzimit:

Kandidati/ja duhet të plotësojë dhe të dorëzojë pranë Drejtorisë Ekonomike dhe Burimeve Njerëzore, dokumentet si më poshtë:

1. Një listë përmbledhëse të gjithë dokumentave që dorëzohen, e cila duhet të jetë e nënshkruar nga kandidati.
2. Një kërkesë për aplikim, e cila duhet të përmbajë në formë të përmbledhur kërkesën për punësim në pozicionin e shpallur. Kërkesa në formë të përmbledhur duhet të përmbajë:

- Emrin dhe mbiemrin e kandidatit;
 - Adresën e saktë e banimit;
 - Numrin e telefonit dhe celularit;
 - Adresën e e-mail-it;
 - Datën e kërkesës;
 - Nënshkrimi: Emri, mbiemri dhe firma me shkrim dore.
3. Jetëshkrimi i plotësuar në përputhje me formatin europass;
 4. Motivimi për vendin e punës për të cilin konkurron;
 5. Deklaratat dhe formularët si më poshtë:
 - a. Deklarata e pasurisë dhe interesave private “*Për kandidatët për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë*”¹-**shiko shënimin fundor**;
 - b. Deklarata për kontrollin e figurës;
 - c. Formulari i Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit;
 - ç. Formular Vetëdeklarimi-Dekriminalizimi;
 - d. Formulari i Vetëdeklarimit-Autorizimi për institucionin për verifikimin e gjendjes gjyqësore;

Formularët b, c, ç, d, janë bashkëlidhur këtij njoftimi.
 6. Fotokopje e diplomës dhe listës së notave;
 7. Fotokopje e librezës së punës (*të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë*);
 8. Fotokopje e letërnjoftimit (ID);
 9. Dokumentin që vërteton njohjen e gjuhës së huaj;
 10. Vërtetimin e gjëndjes shëndetësore dhe për aftësinë për punë (*nga KML*);
 11. Vërtetimin e gjëndjes gjyqësore ose formularin e plotësuar që autorizon institucionin për verifikim;
 12. Vërtetimin nga gjykata dhe prokuroria që nuk është në ndjekje penale;
 13. Vlerësimin e punës nga punëdhënësi i fundit;
 14. Vërtetimin nga institucioni që ka punuar se nuk ka masë disiplinore në fuqi;
 15. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

¹ Në zbatim të **Udhëzimit nr. 927, datë 01.11.2021** të ILDKPKI-së, kandidatët janë të detyruar të **plotësojnë online** deklaratën e pasurisë dhe interesave private “*Për kandidatët për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë*” (shiko udhëzimet përkatëse: https://www.ildkpkj.al/manuale_dhe_udhezime/).

Për të bërë të mundur hapjen e llogarisë nga ku kandidati do të plotësojë deklaratën online, duhet që kandidatët të dërgojnë në adresën e-mail-it: erion.tafaj@gjk.gov.al, të dhënat si vijojnë: 1. numrin personal të identifikimit; 2. numrin e telefonit; 3. adresë e-mail-i. Të dhënat përkatëse (**emri i përdoruesit dhe fjalëkalimi**) për të aksesuar në llogarinë e krijuar, do të dërgohen me e-mail në momentin e krijimit të saj. Varianti i printuar i deklaratës (*e firmosur në çdo faqe*) do të dorëzohet në Gjykatën Kushtetuese bashkë me dokumentat e tjera të kandidatit.

Mënyra e dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar:

Kandidati/ja duhet të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar:

- ÷ Në protokollin e Gjykatës Kushtetuese ose pranë Drejtorisë Ekonomike, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.
- ÷ Me postë (*data e postimit me postë të jetë brenda afatit të caktuar për paraqitjen e dokumentave*).

Afati për dorëzimin e dokumenteve përfundon në datën 30.06.2026.

Rezultatet e verifikimit paraprak

Komisioni i pranimit, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, bën verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kushtet e përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Kandidatët që plotësojnë kushtet e përcaktuara në shpalljen për konkurrim do të renditen në një listë sipas rendit alfabetik, e cila do të shpallet në faqen zyrtare të Gjykatës Kushtetuese.

Kandidatët që nuk kualifikohen do të njoftohen individualisht nga njësi përgjegjëse për shkaqet e moskualifikimit, në të njëjtën ditë me shpalljen e listës së verifikimit paraprak.

Kandidatët, të cilët rezultojnë të pakualifikuar, ***brenda 2 (dy) ditëve pune*** nga data e njoftimit individual mund të paraqesin ankesë me shkrim pranë komisionit të pranimit.

Ankesat zgjidhen ***brenda 2 (dy) ditëve pune*** nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët vlerësohen për jetëshkrimin dhe dokumentacionin e dorëzuar, për intervistën me gojë dhe testimin me shkrim, për njohuritë, arsyetimin dhe aftësitë e hartimit.

Në lidhje me aftësinë draftuese, kandidatët do të testohen me shkrim, në mjediset e Gjykatës Kushtetuese. Kandidatëve do t'u jepet një temë/kazus i caktuar për të cilin do t'u kërkohet të përgatisin një relacion/opinion ligjor.

Pas përfundimit të testimit me shkrim, kandidatët do të intervistohen me gojë, sipas rendit alfabetik.

Struktura e ndarjes së pikëve të vlerësimit të kandidatëve është:

- a) 50 pikë për dokumentacionin e dorëzuar;
- b) 30 pikë për testimin me shkrim;
- c) 20 pikë për intervistën me gojë.

Testimi i kandidatëve do të zhvillohet në datën 14.07.2026, duke filluar nga ora 10:30, në mjediset e Gjykatës Kushtetuese.

Grafiku i datave të zhvillimit të procedurës paraqitet si më poshtë:

Grafiku i datave të zhvillimit të procedurës:

Dorëzimi i dokumenteve:	nga data 15.06.2026 deri më 30.06.2026
Shpallja e listës paraprake të kandidatëve të kualifikuar:	03.07.2026
Ankimi për kualifikimin paraprak	deri në 2 ditë pune nga data e shpalljes
Zgjidhja e ankimeve për kualifikimin paraprak:	deri në 2 ditë pune nga data e përfundimit të ankimit
Lista finale e kandidatëve të kualifikuar:	10.07.2026
Testimi me kandidatët e kualifikuar	14.07.2026, ora 10:30
Njoftimi i vendimit paraprak të Komisionit të Posaçëm të Pranimi (KPP) për fituesit	16.07.2026
Ankimi për vlerësimin e KPP-së:	deri në 2 ditë pune nga data e shpalljes
Zgjidhja e ankimeve:	deri në 2 ditë pune nga data e përfundimit të ankimit
Renditja e kandidatëve ² :	28.07.2026

Për sqarime të mëtejshme mund të kontaktoni me Drejtorinë Ekonomike Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në numrin e telefonit 068 20 80 345.

**DREJTORIA EKONOMIKE, BURIMEVE NJERËZORE
DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

Tiranë, më 12.06.2026

² Renditja e kandidatëve mund të ndryshojë, në rast se kandidati pas mbërritjes së përgjigjes zyrtare nga institucionet përkatëse nuk kalon verifikimet e figurës dhe/ose verifikimin e pasurisë dhe interesave private.